



FIUAD: 74/2020

Datë: 29/04/2020

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës,

në konsultim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, bazuar në paragrafin (1.11) të nenit 14 dhe paragrafin (2) të nenit 66 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18, 15 Qershor 2016) nxjerr këtë:

UDHËZUES

për zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit gjatë periudhës COVID-19

1. Me qëllim të zbatimit të masave të kujdesit të duhur ndaj klientit të parapara me Ligjin Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (ligji për PPP/LFT) gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, subjekteve raportuese të përcaktuara sipas paragrafit 1.1 të nenit 16 të këtij ligji, u lejohet përkohësisht të përdorin masa alternative për të identifikuar klientët dhe verifikuar identitetin e tyre pa prezencë fizike nga distanca.
2. Ky udhëzues mbështetet në Rekomandimet e FATF¹ dhe Egmont Grupës².
3. Qasja e rekomanduar sipas këtij udhëzuesi është neutrale sa i përket teknologjisë (d.m.th., nuk preferon ndonjë lloj të veçantë të komunikimit elektronik), por ka për qëllim që të ndihmojë subjektet raportuese të përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzuesi (bankat) në zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit (KDK) të përcaktuar sipas nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT. Bankat rekomandohen të përdorin të gjitha masat shtesë që mund t'i kenë sistemet e tyre të teknologjisë informative të cila ofrojnë siguri për të parandaluar mashtrimet.

¹COVID-19-related ML/TF risks and potential policy responses

² COVID-19 emerging risks, Egmont Group



Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Pristina Kosovë
Telefoni: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103
Web site: <http://fiu.rks-gov.net>
E-mail: fiu@fic-ks.org



4. Ky udhëzues do të zbatohet vetëm për krijimin e marrëdhënies afariste (hapjes së llogarisë rrjedhëse bankare dhe kartelave të debitit) me klientët me klientët që janë përfitues të pakos qeveritare, me qëllim të limituar për të pranuar mjetet dhe të njëjtat të tërhiqen, që kanë të bëjnë me zbatimin e Pakos Emergjente Fiskale, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Pakon Emergjente Fiskale, Nr.01/19 të datës 30.03.2020 dhe Vendimin nr. 31/2020 të datës 03.04.2020 të Ministrisë të Financave dhe Transfereve, dhe/apo vendimet e tjera pasuese të mundshme të kësaj natyre gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.
5. Kjo gamë e kufizuar e produktit dhe/apo shërbimit bankar e përcaktuar si në pikën katër të këtij udhëzuesi, mund të zgjerohet vetëm pasi të ketë përfunduar urgjenca dhe të arrihet KDK, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për PPP/LFT.
6. Subjektet raportuese të përcaktuara si më lartë, udhëzohen si në vijim:
 - të përdorin masa alternative gjatë procesit të identifikimit të klientit dhe verifikimit të identitetit të tij;
 - të përdorin kopje elektronike (skanimin ose fotografimin) të dokumentacionit të besueshëm dhe të pavarur (sipas pikës 7 të këtij udhëzuesi) për të verifikuar identitetin e klientëve ose kompanive individuale.
7. Pasi që klientët të kenë siguruar kopjet e dokumenteve të identifikimit, bankat duhet të kenë parasysh gjithashtu të kontrollojnë identitetin e tyre përmes së paku njëres nga metodat e mëposhtme:
 - video-komunikimit (thirrje) për të krahasuar identitetin fizik të një klienti me kopjet e skanuara ose të fotografuara të dokumenteve të identifikimit, si dhe prezantimi i dokumentit identifikues i cili duhet të shihet qartë në kamerë.
 - kërkoni nga klienti të ju siguroj një pamje përballë (selfie) të vetës së tyre të qartë, e cila mund të krahasohet me kopjet e skanuara ose të fotografuara të dokumenteve të identifikimit.
 - telefononi klientin për të bërë pyetje në lidhje me identifikimin e tyre, konfirmimin e arsyes për të kërkuar shërbim dhe/ose pyetje të tjera që mund të ndihmojnë në konstatimin nëse klienti është ai që pretendon se është.



Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Pristina Kosovë
Telefoni: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103
Web site: <http://fiu.rks-gov.net>
E-mail: fiu@fic-ks.org

8. Të gjitha bankat që në periudhën e pandemisë COVID-19, zbatojnë masat alternative të kujdesit të duhur ndaj klientit të përcaktuara me këtë udhëzues, duhet ta bëjnë këtë në mënyrë efektive dhe në proporcion me rreziqet e identifikuar për marrëdhëniet me persona fizikë dhe juridikë.
9. Bankat kanë përgjegjësinë primare që, krahas kujdesit të duhur ndaj klientit të paraparë në këtë udhëzues, të zbatojë sisteme të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë procedurën e bazuar në rrezik, për të vlerësuar nivelin e rrezikut të klientit ose pronarit përfitues për të cilin ofrohet produkti apo shërbimi.
10. Të gjitha marrëdhëniet e krijuara me klientët bazuar në përdorimin e masave alternative për të identifikuar klientët dhe verifikuar identitetin e tyre gjatë periudhës COVID-19, do të bllokohen/mbyllen nëse klienti nuk paraqitet në degë të bankës për të bërë përditësimin e të dhënave në një afat prej 30 ditëve, pasi të ketë përfunduar gjendja emergjente për shëndetin publik e shpallur nga organi kompetent.. Klientët që shprehin gatishmërinë për të vazhduar marrëdhënien e krijuar afariste, duhet të identifikohen dhe verifikohen sipas dispozitave në fuqi të Ligjit për PPP/LFT.
11. Përrjashtimisht, me qëllim të zbatimit të Masës 15 të Pakos Fiskale Emergjente të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me COVID-19, bankat mund të krijojnë marrëdhënie të biznesit me klientët pa “praninë fizike”, vetëm me dokumentacionin të cilin e ofron Ministria e Financave dhe Transfereve, ndërkohë që dokumentacionin i hapjes së llogarive të kompletohet në pajtim me pikën 10 të këtij udhëzuesi.
12. Të gjitha të dhënave të pranuar në mënyrë elektronike do të ruhen dhe mirëmbahen në harmoni me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për PPP/LFT.
13. Ky udhëzues hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në një njoftim tjetër nga NjIF-K.

Prishtinë, 29/10/2020.

Dardan NUHIU
Drejtore, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës



Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Pristina Kosovë
Telefoni: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103
Web site: <http://fiu.rks-gov.net>
E-mail: fic@fic-ks.org